


## UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



Finalizing of the Teaching Reform  
New MS Studies at AUT  
18 MS Programs

Table 3: MSc program: SWG of Agriculture and Environment and specific SWG

No.	MSc program	Faculty / SWG	SCC	Letter of Endorsement
1	MSc in Agronomy Science (Agronomy; Horticulture; Plant Protection)	Agriculture & Environment	+	+
2	MSc in Livestock Science and Aquaculture		+	+
3	MSc in Renewable Energy		+	+
4	MSc in Environmental Engineering and Water Management with 2 specialization: Water management and Management of Natural Resources	Specific SWG / FBM	+	+
5	MSc in Digitalization and Automation in Agriculture	Specific SWG / FBM	+	+
6	MSc in Landscape Planning and Architecture	Specific SWG / FBM	+	+
7	Executive Master in Quality and Standard Management in Agri-Food System	Specific SWG	+	+



## Prezantohet podcasti "UBT Talk", një hapësirë e re komunikimi

Universiteti Bujqësor i Tiranës prezantoi podcastin me fokus arsimin, shkencën dhe inovacionin. Episodi i parë solli Prof. Hubert Hasenauer, i cili ndau perspektiva mbi universitetet.

**Lexo në faqen 3**

## Formësohet oferta e re akademike 2026-2027, BOKU në UBT për programet e reja Master

Në misionin e 19-të të përbashkët BOKU-UBT, delegacioni nga Vjena erdhi për të diskutuar çështje kyçe lidhur me përmirësimin e procesit të administrimit, mësimdhënies, promovimin e programeve të mobilitetit të UBT-së dhe aspekte të tjera të rëndësishme të reformës. Gjatë punimeve u diskutuan 18 programet master, të cilat do të kalojnë për miratim edhe në Ministrinë e Arsimit. Analizat administrative dhe akademike u fokusuan në situatën ekzistuese, përgjegjësitë dhe nevojat institucionale të universitetit. **Lexo në faqen tjetër...**

# Misioni i BOKU në UBT, tre ditë intensive



Ditën e parë delegacioni i BOKU në UBT u përqendrua në zbatimin e reformës akademike dhe administrative. Prof. Dr. Ardian Maçi theksoi arritjet e reformës UBT-BOKU 2030 në hartimin e kurrikulave të reja, ndërsa Prof. Dr. Xhelil Koleci dhe Petra Winter prezantuan progresin e programit VetMed, përfshirë përpunjen me standardet EAVE dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Gjithashtu, Zv/Rektori Prof. Dr. Ilir Kapaj paraqiti një përmbledhje të programeve të rishikuara në kuadër të reformës akademike. **Lexo më shumë...**



Misioni i BOKU në UBT në ditën e dytë u përqendrua në forcimin e administrimit universitar, zhvillimin e programeve të doktoraturës dhe strategjitë e komunikimit institucional, përmes analizës së proceseve aktuale, identifikimit të nevojave dhe përcaktimit të hapave konkretë për përmirësim. U diskutuan rregulloret dhe praktikrat e programeve PhD, mobiliteti akademik dhe procedurat për studentët, si dhe u trajtuan qasjet e marketingut dhe promovimit të programeve të studimit. **Lexo më shumë...**



Dita e fundit e misionit të 19-të të BOKU në UBT u përqendrua në përmbylljen e diskutimeve mbi avancimin e reformave akademike dhe institucionale në kuadër të strategjisë AUT-BOKU 2030, ku Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, falënderoi delegacionin për kontributin në fushat e doktoraturave, administrimit dhe komunikimit. Prof. Dr. Hubert Hasenauer prezantoi rezultatet e arritura dhe theksoi hapat e ardhshëm. **Lexo më shumë...**



## Universiteti Bujqësor i Tiranës prezanton podcastin “UBT Talk” – publikohet episodi i parë

Universiteti Bujqësor i Tiranës prezanton “UBT Talk”, podcastin e ri zyrtar që synon të sjellë në vëmendje tema kyçe mbi arsimin, shkencën, inovacionin dhe zhvillimet që formësojnë të ardhmen. Podcasti “UBT Talk” do të shërbejë si një platformë e hapur dialogu, ku ekspertë, akademikë, profesionistë nga fusha të ndryshme dhe studentë do të ndajnë ide, përvoja dhe vizione për të ardhmen.

Episodi i parë erdhi me një të ftuar të veçantë, profesorin **Hubert Hasenauer**, akademik i njohur ndërkombëtarisht dhe profesor në BOKU, si dhe anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë bisedë me Drejtoreshën e Marrëdhënieve me Publikun në UBT Besmira Pelushaj ai ndau perspektivat e tij mbi rolin e universiteteve përballë sfidave globale, rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, ndikimin e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në arsim, si dhe të ardhmen e brezit të ri dhe zhvillimin e institucioneve akademike. **Ndiqui episodin e parë**



# UBT zgjeron bashkëpunimet përmes tre marrëveshjeve



Universiteti Bujqësor i Tiranës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me **AKU** dhe **AKVMB**, duke forcuar lidhjen mes universitetit dhe institucioneve kryesore të sigurisë ushqimore në vend. Marrëveshja synon rritjen e cilësisë së formimit profesional dhe përfshirjen më të madhe të të diplomuarve në tregun e punës. Për UBT, ky partneritet rrit rolin e tij si aktor kyç në zhvillimin e sektorit dhe në politikëbërje, ndërsa për studentët krijon më shumë mundësi punësimi, përvojë praktike dhe aftësi të lidhura drejtpërdrejt me kërkesat e tregut. **Lexo më shumë...**



Një memorandum i rëndësishëm bashkëpunimi u firmos me **Ministrinë e Mjedisit**, duke synuar forcimin e rolit të universitetit në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri. Përmes këtij partneriteti, UBT do të kontribuojë me ekspertizë akademike dhe projekte kërkimore, ndërsa studentët dhe të diplomuarit përfitojnë mundësi më të mëdha për përfshirje profesionale. **Lexo më shumë...**



Një hap i ri bashkëpunimi për kërkimin shkencor dhe menaxhimin e qëndrueshëm vjen përmes marrëveshjes mes **Universitetit Bujqësor të Tiranës** dhe **Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit**. E firmosur nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Drejtoresha znj. Jorida Muho, marrëveshja parashikon projekte të përbashkëta kërkimore, praktika për studentët në Parkun Kombëtar të Butrintit dhe angazhim në monitorimin ekologjik. Ky partneritet krijon mundësi konkrete për studentët. **Lexo më shumë...**



### **UBT hap dyert për maturantët: Bashkëpunim i ri me shkollat e mesme dhe profesionale të Bashkisë Kamëz**

Universiteti Bujqësor i Tiranës vijon të zgjerojë bashkëpunimin me institucionet e arsimit parauniversitar, duke mirëpritur në kampusin e tij Drejtorët e shkollave të mesme dhe profesionale të Bashkisë Kamëz. Takimi kishte në fokus prezantimin e programeve të studimit të universitetit dhe krijimin e mundësive të reja bashkëpunimi në shërbim të orientimit akademik të maturantëve.

Gjatë këtij takimi u diskutua për ndërtimin e një bashkëpunimi më të ngushtë mes UBT dhe shkollave të mesme, përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, vizitave informuese të maturantëve në kampusin universitar dhe prezantimeve orientuese që i ndihmojnë të rinjtë të njihen nga afër me programet e studimit dhe perspektivat profesionale që ofron universiteti. **Lexo më shumë...**

### **Maturantët e “J. F. Kennedy” zbulojnë nga afër jetën universitare në UBT**

Një ditë ndryshe, plot energji dhe kuriozitet! Rreth 40 maturantë të shkollës “J. F. Kennedy” në Tiranë vizituan UBT për t’u njohur nga afër me programet e studimit dhe jetën universitare. Prezantimi u realizua nga Drejtoria e Marrëdhënies me Publikun dhe Zyrat e Karrierës, të cilat i njohën nxënësit me 13 programet Bachelor që ofron UBT.



Vizita vijoi me një tur në ambientet universitare, ku maturantët panë nga afër auditorët, hapësirat mësimore dhe bibliotekën me fond të pasur botimesh shkencore, artistike dhe kulturore. **Lexo më shumë...**





## UBT merr pjesë në Parlamentin Rural Shqiptar

Universiteti Bujqësor i Tiranës mori pjesë në Parlamentin Rural Shqiptar me fokus tek "Shqipëria rurale në rrugën drejt Evropës: çfarë do të thotë për komunitetet dhe territoret" një forum i rëndësishëm që bashkon aktorët kryesorë që po formësojnë të ardhmen e zonave rurale në Shqipëri.

UBT u përfaqësua në këtë aktivitet nga Rektori, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Zv/Rektorja për Shkencën dhe Projektet Prof. Dr. Erinda Lika e cila ishte pjesë e një prej paneleve të eventit.

Një grup studentësh nga UBT ishin po ashtu pjesë e këtij event i cili shënoi vitin e katërt.

**Lexo më shumë...**




## Workshop mbi rrezikun mjedisor nga ndotja industriale: Ish-uzina e superfosfatit në Laç

Në bashkëpunim me Universitetin e Lorrenës Francë dhe programin READ, ky aktivitet bëri bashkë pedagogë, studiues dhe studentë të fushave të mjedisit dhe shkencave natyrore në UBT.

Qëllimi i studimit ishte të vlerësohej përmbajtja dhe lëvizshmëria e metaleve të rënda në tokë, si dhe të kuptohej se si këta elementë janë transformuar në mjedis pas më shumë se 25 vitesh nga mbyllja e aktivitetit industrial.

Projekti u prezantua nga Dr. Erdona Demiraj, koordinatore e projektit, e cila ka punuar së bashku me studiueset Dr. Irena Duka dhe Dr. Nereida Malo. **Lexo më shumë...**





## "Bujqësi e zgjuar", UBT pjesë e "Match-Maker Albania 2026"

Zv. Rektorja Prof. Asoc. Romina Koto prezantoi platformën PHITO, një zgjidhje digjitale që synon të lidhë të dhënat me aktorët e zinxhirit bujqësor përmes një sistemi të thjeshtë dhe të aksesueshëm.

Nga ana tjetër, Prof. Alketa Grepcka prezantoi programin inovativ të studimit të UBT-së "IT në Bujqësi dhe Mjedis".

"Smart Agriculture Zone" mbledhi institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, investitorë të huaj, si dhe startup-e inovative që prezantuan zgjidhje për monitorimin inteligjent të tokës, parashikimin e dëmtuesve dhe optimizimin e proceseve bujqësore. **Lexo më shumë...**



## Studentët e UBT, praktika në terren për monitorimin mjedisor



Studentët e vitit të tretë të programeve "Inxhinieri Agromjedisi" dhe "Menaxhim i Burimeve Natyrore" realizuan praktikën e parë në terren, e fokusuar në tre zona kryesore me rëndësi mjedisore: Baseni i Lumit Ishëm, zona e mbrojtur Kune-Vain dhe Liqeni i Shkodrës.

Kjo praktikë synon integrimin e njohurive teorike me aplikimin praktik në terren, duke zhvilluar aftësitë kërkimore dhe analitike të studentëve.



Përmes kësaj përvoje, studentët forcojnë aftësitë për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave mjedisore në kushte reale. **Lexo më shumë...**



### Arti bashkon të rinjtë në koncertin e përbashkët UBT – “J. F. Kennedy” për festat e 7-8 Marsit

Në një atmosferë festive dhe në një sallë me afro 300 të pranishëm, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe shkolla e mesme “J. F. Kennedy” organizuan një koncert të përbashkët me rastin e festave të 7 dhe 8 Marsit, duke sjellë në skenë talentin dhe energjinë e studentëve dhe maturantëve.



Të rinjtë e talentuar të UBT dhe J.F.Kennedy patën mundësinë që të tregonin talentet e tyre shumë-dimensionale, disa prej tyre duke u ngjitur për herë të parë në një skenë me kaq shumë të pranishëm.

Koncerti u mbajt në ambientet e UBT dhe nisi në mënyrë simbolike me interpretimin e një valleje tradicionale, e cila çeli siparin e një feste të veçantë dhe të paharrueshme.

Tingujt e violinës, kitarës dhe çiftelisë, i dhanë shfaqjes një atmosferë të ngrohtë dhe festive. Skena u pasurua edhe me interpretime poetike, këngë dhe kërcime tradicionale nga zona të ndryshme të Shqipërisë.



Publikun e përshëndeti Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, i cili u shpreh se asnjëherë më parë nuk e kishte parë sallën më të bukur, duke theksuar se këto iniciativa jo vetëm që promovojnë kulturën dhe artin, por edhe afrojnë më shumë të rinjtë me jetën universitare. **Lexo më shumë...**

